

V E N D I M
Nr.192, datë 28.4.1993

**PËR MBËSHTETJEN E REZOLUTES 820 TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË
PËR FORCIMIN E METEJSHËM TË SANKSIONEVE NDAJ REPUBLIKËS FEDERATIVE
TË JUGOSLLAVISË (SERBISË DHE MALIT TË ZI)**

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshiili i Ministrave

V E N D O S I :

1. Mbështetjen e Rezolutës 820 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për forcimin e mëtejshëm të sanksioneve ndaj Republikës Federative të Jugosllavisë (Serbisë dhe Malit të Zi).

Qeveria e Republikës së Shqipërisë përkrah shkallëzimin e mëtejshëm të sanksioneve të RF të Jugosllavisë në fushën politike, ekonomike, të transportit dhe të pasurive jugosllave jashtë, të parashikuara në këtë rezolutë.

2. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse të zbatojnë dispozitat e rezolutave të mëparshme dhe të rezolutës së fundit nr.820, për ta bërë sa më të efektshëm presionin ndërkombëtar ndaj RF të Jugosllavisë (Serbisë dhe Malit të Zi).

3. Për çdo dyshim ose thyerje të embargos Ministria e Punëve të Jashtme njofton komisionin e posaçëm të verifikimit pranë Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi